LIBËR PROTOKOLLI

Datë 29.04.2025 Nr.prot 7

Sot në sallën e mbledhjeve të KB Devoll Zhvillohet mbledhja e rregullt sipas njoftimit të datës 24.04.2025. Të pranishëm në sallë: Ilir Hoxha, Valbona Spaho, Imelda Çuçka, Alfredi Gjata, Paolo Spaho Lindita Çokani, Vladimir Kello, Ermena Xhaçi, Albana Stoti, Arsida Mazalliu, Genti Demçollari.

Mbledhja deklarohet e hapur!

A. Gjata: Vazhdojmë me pikën 1 të rendit të ditës. "Miratimi i rendit të ditës. Hapet votimi: 11 vota pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Vazhdojmë me pikën 2. "Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 28.03.2025. Hapet votimi: 11 vota pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Vazhdojmë me pikën 3 "Projekt Vendimi Nr 27 datë 24.04.2025 "Për miratimin e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për bllokndihmën ekonomike për muajin Mars 2025.

Vladimir Kello: Shikoj që kjo ndihmë ekonomike është më shumë për fshatin.

Besmir Dalo: Në qytet ka më pak aplikues. Ka të bëjë vetëm me nr e aplikuesve.

Hapet votimi: 10 pro, 1 kundër, 0 abstenim.

A. Gjata: Vazhdojmë me pikën 4 "Projektvendimi Nr 28 datë 24.04.2025 "Për miratimin e planit të Emergjencave Civile në Bashkinë Devoll për vitin 2025."

Ilir Hoxha: Para se të vazhdojmë kisha dëshirë për të shtuar. Është e mundur që mund të futet në listën e nd. ekonomike, që qytetari i cili është me çrregullime të sistemit nervor, jeton vetëm. Mund të ketë rreth 15 vite i mbyllur. Çështja është që ai kartë ID nuk merr dot pasi nuk ven për aplikim. Besmir Dalo: Unë e di që kemi vajtur disa herë për të marrë disa dokumenta në menyrë që ta ndihmojmë por ai nuk pranon të flasë.

Alfredi Gjata: Do të flasim përsëri me shërbimin social. Për sa i përket PV 28 kemi këtu specialistin i cili do të na sqarojë në lidhje me këtë projektvendim.

Ylbon Steno: Janë të përcaktuara të gjitha pikat, rreziqet etj. Në rastet fatkeqësish bëhet vlerësimi i dëmeve, sipas mundësive bëhet demshpërblim. Për këtë arsye ngrihen komisione bashkë me kryetarin e Bashkisë për të qenë në gatishmëri. Rreziqet më të mëdha janë nga zjarret, reshpitje dherash etj. Duke ditur këto hyjnë planet tona veprore/dimerore. Në bashkëpunim me MSZHSH. Vladimir Kello: Marr shkas nga zjarret në malin e Moravës Sinicë, Hoxisht. Unë i kam dhe fotografi për besoj se personi përgjegjës për mirëmbajtjen është bashkia. Kërkoj për kryetari i Bashkisë të japë informacion të detajuar në shkrim në lidhje me rrethin e zjarrit në malin e Moravës. Hapet votimi për PV 28, 11 vota pro 0 kundër, 0 abstenim.

Alfredi Gjata: Vazhdojmë me pikën 5. Projektvendimi Nr 25 datë 24.04.2024 "Për miratimin e planit operacional 2025."

Plani operacional është një plan me afat 1 vjecar, konsiston në
fjetjen e mundësive për të krijuar tek ardhura për komunitetin
dhe banorët përreth si dhe për t'i dhënë zgjidhje problemeve ekzistuese
Vladimir Kello: Ju skeni projekt, për kuvendin e bashkisë.
Gëzim Demçolli: Kemi miratuar ndryshimin e titullit të ngastrave të
caktuara për fotovoltaike. Për ironi të situatës i kemi hequr nga
fondi pyjor, i kemi dhënë pasqyrë. U nisë nga fjala juaj që
nuk jane dhe nuk i bëjmë, ky terren që menaxhohet nga ky bashkë
dhe është fare e ligjshme, po ke vëllnet të gjelberosh, bëj analizën
e tokës, ngeri nismë dhe me donacione, ndihmë nga shkollat
bamunitetit. Deri më sot asnjë nuk ka mendueur afatgjatë
të mbjellë sot e t'i gëzojnë brezat. Si psh. parku i Korçës
është i mrekullueshëm që e gëzojnë të gjithë, është mbjellë
dikur. Por ky pyllet po ka një vizion të tillë, e gjen dhe
e bën.
Hapet votimi: 11 pro, 0 kundër, 0 abstenim
Vazhdojmë me PV 30 datë 24.04.2024 "Për miratimin e nd.
financiare për pebballumin e shpenzimeve të varrimit nga fondi
rezervë i Bashkisë për qytetarë në nevojë",
Alfredi Gjata: Bëret fjalë për një person me skizofreni i
braktisur nga familja. Ky është një rast që skemi çar diskutojmë
kolegjmë në votim: 11 pro, 0 kundër, 0 abstenim.
Jashtë rendit të ditës kemi dhe 2 informacione nga audituesi.
Këshilltarët informohen dhe sqarohen nga përfaqësuesi
Mjedhja deklarohet e mbyllur!

Protokollues:
Kostandina Brakolli

Valbona Zmako

Vladimir Kello

Alfredi Gjata